



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI

Nr. 3226/1 Prot.

Tiranë, më 08.11 2024

VENDIM

Nr. 72 dt. 08.11 2024

“PËR INTERPRETIMIN E STATUTIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 3, 25, 38, 45 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit Nr. 824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin nr. 57, datë 29.1.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenin 7, 13, 20, 39, 53, 54, 59 të Statutit të UST-së, nenin 10 të Rregullores së UST, Rregullores për Rekrutimin e Personelit Akademik dhe Ndihmës Akademik në UST si dhe Rregulloreve të njësisve kryesore, pas interpretimit të nenit 13 pika 4 gërma a) të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 08.11.2024,

V E N D O S I :

1. Të gjitha ngarkesat mësimore do të përcaktohen nga departamenti, anëtar i të cilit është stafi akademik.
2. Konkursët e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, do të kryhen nga departamenti përkatës ku janë të vendosura lëndët ose modulet.
3. Ky vendim ti përcillet për njohje, zbatim dhe publikim të gjitha njësisve kryesore, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

